



**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës**  
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**



01- Nr 27-29  
Me datë 31.12.2024

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligjin Nr.08/L-260 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, nenit 53 të Ligji Për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 44.1 Statuti i Komunës së Mamushës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës merr këtë:

**V E N D I M**

**Anulim i vendimit me numër të Protokollit 01.Nr.21/24 e datës 29.11.2024**

**Neni 1**

**ANULOHET**- Vendimi me numër të Protokollit 01.Nr.21/24 e datës 30.11.2024, Transfer nga kategoria ekonomike investimeve kapitale në kategorinë ekonomike investime kapitale marrë në Kuvendin Komunal të Mamushës.

**Neni 2**

Ky vendim anulohet dhe si i tillë nuk do të krijon pasoja juridike.

**Neni 3**

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në wëp faqe të Komunës së Mamushës, sipas kushteve të parapara në nenet 81 dhe 82 të LVL-ës.

**A R S Y E T I M**

Kuvendi Komunal në Mamushë në mbledhjen e mbajtur me datën 30.11.2024 mori vendim me numër të Protokollit 01.Nr.21/24 e datës 30.11.2024 për Transfer nga kategoria ekonomike investimeve kapitale në kategorinë ekonomike investime kapitale, gjatë kohës për deri sa është marrë ky vendim projekti i destinuar nga nën-programi (85014), fondi 10 kodi funksional (0820), nga kategoria ekonomike investime kapitale (30), projekti Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Mamushës kodi i projektit (54780) shuma prej 14,900.00€ (% transferit për këtë program nga fondi burimor 10 është 14.0%, e që është kërkuar që të transferohet në, nën-programin Infrastrukturë Rrugore (18014, fondi (10), Kodi funksional (0451), në kategorinë ekonomike investime kapitale (30), projekti Renovimi i asfaltimit, kanalizimi dhe rrugëve me kubëza në rrugët Kisla-Cumuriyet-Bahacelik-Huryet-Asket-Demirci dhe Kultur, Kodi i projektit (55058) shuma prej 14,900.00 €.

Ky vendim është marrë pasi që projekti i Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Mamushës, ka qenë në shqyrtim në OSHP dhe për arsye që mjetet të mos shkojnë në suficit, kemi kërkuar që këto mjete të transferohen në kategori tjetër ekonomike, por pas marrjes së vendimit 01.Nr.21/24, kemi pranuar lëndën nga OSHP për vazhdimin e procedurave të Ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës në Mamushës.

Andaj, duke marrë parasysh se është lejuar zhvillimi i procedurave për Ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në Mamushës, nuk duhet që të mjetet të transferohen siç është cekur në vendimin 01.Nr.21/24 e datës 29.11.2024.

Të njoftohen :  
Zyra e Kryetarit  
MAPL  
Thesari  
Arkivi

**Kryesues i Kuvënit Komunal në Mamushës**

**Neçmedin Morina**

